



RAPORT TEKNIK

OBJEKTI: RIKONSTRUKSION I EKO KAMPIT SHEGAN.



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Syri i Sheganit është një burim i madh karstik, që gjendet në afërsi të fshatit Kosan, të Njësisë Administrative Bajzë, bashkia Malësi e Madhe, pranë buzës lindore të liqenit të Shkodrës, në lartësinë rreth 6 m mbi nivelin e detit. Syri i Sheganit përbën një burim të madh karstik, që del vertikalisht në çarjet tektoniko-karstike dhe lidhet me dy burime të tjera karstike, që quhen hurdhana, me prurje deri 1500 l/sek. Uji i burimit të Sheganit del nga një oxhak karstik me thellësi rreth 22 – 28 m dhe gjerësi 3 – 5 m me ujë të pastër dhe të ftohtë, që vjen nga ujërat karstike të Alpeve Perëndimore të Shqipërisë. Eksplorimet e tanishme kanë arritur deri në gjatësinë 80 m të rrugës që bëjnë ujërat e këtij burimi. Më pas është një shpellë e shëmbur që pengon eksplorimin. Në ujërat e tyre ka peshq e gjallesa të tjera. Burimet krijojnë një mjedis shumë tërheqës me vlera shkencore (hidrologjike, speleologjike, gjeomorfologjike), didaktike, estetike e turistike. Vizitohet sipas itinerarit qyteti i Shkodrës – Koplik – Ivanaj – Gashaj – Shegan.

QËLLIMI I PROJEKTIT.

Qëllimi i projektit të objektit Rikonstruksion i Eko Kampit Shegan synon krijimin e kushteve për arritjen e një turizmi të qëndrueshëm.

Zhvillimi i Qëndrueshëm i Turizmit plotëson nevojat e turistëve aktual dhe vendeve pritëse ndërkohe që mbron dhe forcon mundësitë për të ardhmen. Ai nënkupton menaxhimin e të gjitha burimeve në mënyrë të tillë që të plotësohen nevojat ekonomike, sociale dhe estetike ndërkohë që ruan integritetin kulturor, proceset bazë ekologjike, diversitetin biologjik dhe sistemet në mbështetje të jetës. Produktet të qëndrueshme turistike janë ato produkte të cilat funksionojnë në harmoni me mjedisin, komunitetin dhe kulturen lokale në mënyrë që këto të jënë përfituese dhe jo viktime të zhvillimit të turizmit.



GJËNDJA EKZISTUESE




Në godina vërehen probleme të cilat kërkojnë të ndërhyjmë sa më parë për t'i eliminuar dhe mos të rëndohen më tepër. Nga një vlerësim fizik që i është bërë rezulton se : - çatitë e 3 vilave kanë nevojë për rikonstruktion , Ka tavane të dëmtuara - Pajisjet hidrosanitare janë pjesërisht të dëmtuara, - Dyert dhe dritaret janë pjesërisht të dëmtuara. Objektet kanë nevojë dhe të bojatisen.

Oborri i ndërtesave ka nevojë për sistemim si dhe krijimin e nje fushe volejboli në mënyrë që të bëhet një ambient tërheqës për të rinjë dhe turistët e vendit dhe të huaj.

Për personat me aftësi ndryshe në mënyrë që ato të mund të shijojnë mrekullitë e kësaj pjese të liqenit të Shkodrës mendohet realizimi I nje molo për aksesin e tyre me mjetet e përshtatshme për në liqen.

Projekti konsiston në kryerjen e punimeve

PUNIME PER MURIN RRETHUES






Që do të realizohet me kryerjen e këtyre punimeve:

- Germim dhe mbushje kanali K.III
- Shtrese zhavori.
- Themel e xokol b/betoni C 16/20
- Struktura monolite betoni C 16/20
- F.V. rrethim me gardh druri te thjeshte

PUNIME PER RIKONSTRUKSIONIN E NDERTESAVE EKZISTUESE



Që do të realizohet me kryerjen e këtyre punimeve:

Rikonstruktion çatie

Dritare d/alumini.

F.V dyer druri

F.V. Tavan derrase

Boje vaji sipërfaqe druri

F.V. ËC

F.V lavaman porcelani importi


PUNIME PËR SISTEMIMIN E OBORRIT TË NDERTESAVE

Ndërhryrjet konsistojnë në :


Shttrim me pllaka dhe krijimin e një ambjenti të gjelbëruar.

DETAJ I SHITESAVE TE SHESHIT

TIPI 1



- Pllaka guri te gdhendur, 20x40cm i lire
- gri e erret, t=3cm
- Llaç çimento 3 cm
- Shtrese betoni C 16/20,
- (15 cm+zgare hekuri Ø 10/20)
- Çakell 15 cm
- Zhavorr 20 cm
- Toke natyrale



1. Sistemim ambjenti i jashtëm.

Detaj i mbjelljes së pemëve




PUNIME PËR FUSHAT



Punimet konsistojnë në krijimin e një fushe sporti volejboli, ku përshihen punime

- Germim shkemb i forte.
- Transport materiale ndertimi.
- Shtrese çakelli .
- Struktura monolite betoni .
- Komplet rrjete volejboli, poliesteri, e gradueshme, se bashku me shtyllat e pjeset e tyre tubolare per fiksime ne toke, rrjeten, antenat etj. Dimensionet 9.5x1.0 m. Fasho superiore 70 mm e kavo çeliku $\varnothing$ 5 mm. Fasho inferiore 50 mm me korde poliesteri $\varnothing$ 6 mm
- Struktura mbajtëse e tabelës prej çeliku të zinkuar me konsol 3.20 m, e fiksuar në bazamentin prej betoni me ane të bulonerive të pershtatëshme, sipas standarteve
- Bazament betoni të armuar për fiksimin e strukturës së tabelave me ane të bulonerive sipas kërkesës së prodhuesit të strukturës.



Detaj rrjete volejboli.





PUNIME PËR RAMPEN



Punimet konsistojnë:

- Dysheme për Molo druri për personat me aftësi ndryshe.
- Përgatitje e vendosje lënde e rumbullakët.
- Parmakë druri për Molo druri.
- Bojë vaji sipërfaqe druri.



Hartimi i Preventivit



Kosto totale e ndërhyrjes është percaktuar nga preventivi përfundimtarë i objektit, që do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimeve teknike duke marrë parasysh edhe kërkesat e veçanta të Bashkisë në lidhje me standartet e pranuar.

Në hartimin e preventivit cmimet e referencës janë sipas legjislacionit në fuqi (Manuali Teknik i Çmimeve V.K.M nr. 629, datë 15.07.2015).

Standartet në Projektim

Projekti është hartuar në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projekti siguron respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e Projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse. Projektuesi është munduar të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. "Rikonstruksion I Eko Kampit Shegan .

Në hartimin e projektit janë mbajtur parasysh të gjitha normat e miratuar për personat me aftësi të kufizuar, të verberit, etj. Në projekt është parashikuar dhe infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, grupi i projektimit ka përdorur programet e kërkuara kompjuterike, që janë programet më të reja, e me të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit është patur parasysh dhe janë respektuar të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji "për planifikimin e territorit", Rregullorja dhe Legjislacioni në fuqi.

Përgatiti

Ark. Lombardo MICULI

Ing. Julian NOKAJ